

FJALA E DEPUTETIT XHELAL MZIU

E ENJTE 9 QERSHOR 2022

Të nderuar qytetarë,

Të nderuar kolegë,

Pavarësisht se jemi në paraqitjen e këtij akti normativ, nga Ministria e Financave, për shkak të situatës skandaloze ekonomike që kemi si pasojë e mosmenaxhimit si duhet të pandemisë, edhe të luftës, prisja të kishim një paketë mbështetëse, subvencionuese dhe stimuluese për konsumin në Shqipëri. Në fakt, ngrihet një tjetër bord, as bord komunist, as bord fashist, por korruptiv, aq korruptiv është, sa që po të shohim bordin e naftës, kemi një karburant oligarku, që e shet naftën 258 lekë për litër, dhe pak më tej, është një tjetër, që e shet naftën 10% më pak. Këtu shihet sa transparent dhe korruptiv është ky bord apo kjo qeveri në raport me këtë produkt mjaft të rëndësishëm, që e ka tundur thellësisht ekonominë shqiptare.

Lidhur me bordin që po krijoni, në këndvështrimin tim financiar, jep tri efekte negative: së pari, që të kërkosh të krijosh një rezervë në kulmin e krizës, pra kujtoheni si “e ëma e Zeqos”, do të thotë që të shkosh ta blesh këtë produkt fiks në kulmin e krizës; së dyti, të imponosh një biznes për të marrë një kredi, do të thotë që automatikisht të rrisësh koston e këtij produkti; së treti, besoj se edhe herët e tjera që ju keni ofruar garanci sovrane, nuk keni qenë ju aktorët kryesorë, por ka qenë banka ajo që e ka përcaktuar dhe për pasojë e ka rritur çmimin e tyre. Në fakt, e keqja nuk ekziston te biznesi. Ju duhet të tentoni ta rrisni konsumin, sepse vetëm kjo gjë mund ta ulë çmimin dhe varfërinë, por ju e keni goditur që në themel ekonominë shqiptare, mjafton të shohësh vetëm tatimfitimin.

Ne kemi rekord tatimfitimi: 15% është tatimi mbi fitimin në Shqipëri; 10% në Maqedoni; 10% në Kosovë; 9% në Malin e Zi dhe 10% në Maqedoninë e Veriut, madje kemi edhe 8% tatim mbi dividendin, siç do të kaloni së shpejti tatimin e biznesit të vogël në 23%, apo atë të avokatisë dhe të tjera të kësaj fushe, që kërkoni t’i kaloni në seancën e radhës. Një shqetësim tjetër që ka

ngritur Banka Botërore, madje edhe e ka ilustruar, lidhet me paketën e luftës që ju keni paraqitur. Shqipëria, nuk kishte si të ndodhte ndryshe, është në fund të listës. Ky është grafiku i paraqitur në raportin e Bankës Botërore, ku Shqipëria ka dhënë vetëm 0,3% të prodhimit të brendshëm bruto, madje, edhe 0,3%-shin e kemi dhënë vetëm për mbështetje sociale.

Po të shohim Maqedoninë e Veriut, ajo ka dhënë 3,6%. Kaq e vogël është ndihma që ka dhënë edhe në raport me vendet e tjera, saqë nuk ka pasur asnjë lloj efekti. Banka Botërore thekson se kjo shifër shumë e ulët ka ndikuar negativisht për shpopullimin e zonave rurale, si dhe ka ndikuar negativisht në falimentimin e bizneseve të vogla. Ka qenë një situatë vërtet kaotike në raport me vendet e tjera. Vendi ynë për krizën e luftës ka dhënë vetëm 50 milionë euro, madje një pjesë e tyre janë pjesa e inflacionit të pensioneve të vitit të kaluar, dhe nuk ka dhënë asnjë ndihmë në drejtimet e tjera. Mjafton të shohësh vendet e BE-së, të cilat kanë dhënë 6,2% të prodhimit të brendshëm bruto; vendet në zhvillim kanë dhënë 3,1%, ndërsa Shqipëria ka dhënë vetëm 1% për sa i përket menaxhimit të pandemisë.

Këto shifra mjaft të ulëta kanë ndikuar edhe negativisht, por jo vetëm, qeveria shqiptare ndodhet në një paradoks të jashtëzakonshëm. Të gjitha vendet e kanë cenuar buxhetin e tyre, ndërkohë që në Shqipëri ka ndodhur e kundërta, sepse është rritur pjesa e të ardhurave buxhetore. Po ta shikoni këtë grafik, realizimi i 4-mujorit të vitit 2021 me vitin 2022 ka plot 35 miliardë lekë të rinj më shumë ose 300 milionë euro më shumë. Paketa e rezistencës, edhe nëse e quajmë të mirëfilltë, ka shkuar 50 milionë. Ku i ka dërguar Shqipëria 250 milionë euro? E vetmja qeveri në rajon dhe në botë që ka përfituar 250 milionë euro, që, në fakt, duhet t'i kishte dhënë për mbështetje. Ne duhet të sillnim një projekt për ta rishikuar buxhetin, sepse i kanë tepruar të ardhurat. Kjo është situata kritike në të cilën ndodhemi sot: qeveria gëzohet me paratë që merr nga taksat, ndërkohë që qytetari varfërohet keq e më keq.

Një tjetër raport, i cili e ka vendosur në tabelën e qitjes Shqipërinë, është ai i Organizatës së Ushqimit të Kombeve të Bashkuara ose FAO. Shqipëria përsëri në këtë rast është e fundit. Organizata jo vetëm që e akuzon Shqipërinë për shifrën e ulët me të cilën e mbështet bujqësinë, si indikatorin kryesor të vendit, por edhe për atë që jep, e cila është shumë pak. Në raport thuhet: “Shqipëria, në raport me vendet e rajonit, jep 20 herë më pak mbështetje të

drejtpërdrejtë ndaj biznesit”. Ky është grafiku i emetuar nga FAO. Shqipëria është në fundin e listës. Nuk kishte si të ndodhte ndryshe. Maqedonia e Veriut jep 196 euro për hektar, ndërkohë që Shqipëria jep vetëm 45 euro; Kosova jep 69 euro për hektar në mënyrë të drejtpërdrejtë. Madje, FAO akuzon dhe thotë se pjesa që nuk jepet në mënyrë të drejtpërdrejtë, jepet tek institucionet e ndërmjetme korruptive, pra nuk shkon te qytetari.

Ajo që është shqetësuese dhe duhet ta ngremë si shqetësim te ministrja është që kjo pjesë që akordohet të mos kalojë në kalendat e korrupsionit, por të shkojë në mënyrë të drejtpërdrejtë. Do të ishte më se e udhës që këto 250 milionë euro të përfituara të shkonin në mbështetje të bujqësisë, madje FAO dhe Banka Botërore thonë se, nëse Shqipëria do të krijojë standarde, ajo duhet të akordojë 190 deri në 200 milionë euro të tjera në drejtim të bujqësisë për ta mbështetur. Nuk është vetëm ky shqetësim, por kemi edhe një shqetësim tjetër. Po të shohësh, “Global Petrol” ka akorduar një statistikë tjetër, që nxjerr edhe një herë çmimin e naftës në Shqipëri dhe Shqipëria e ka 2,15 euro për litër, Kosova 1,79 euro për litër, Serbia 1,75 euro për litër, Mali i Zi 1,57 euro për litër dhe Maqedonia 1,66 euro për litër.

Çmimi i naftës në Shqipëri është 432 lekë më shumë se në Kosovë; 480 lekë më shtrenjtë se në Serbi; 700 lekë më shtrenjtë se në Malin e Zi dhe 600 lekë më shumë se në Maqedoninë e Veriut. Po përfitoj nga rasti, meqë dje ishim një grup deputetësh në Maqedoninë e Veriut, dhe po ju tregoj çmimet që mora drejtpërdrejt në Maqedoninë e Veriut, në Kosovë dhe në Shqipëri. Nuk mjafton vetëm kjo, por kam edhe një argument tjetër. Në komunikimin që kisha me zëvendësministrin e Bujqësisë, por edhe me ministren e Financave, argumentet e tyre për çmimin e naftës i justifikojmë në disa drejtime, në fakt, edhe produktet e tjera kanë të njëjtin fat.

Sot shkova te një pikë shumice, doja të shkoja tek ato të pakicës, por ato nuk kishin çmime, dhe këto janë çmimet e produkteve të shportës në Shqipëri. Meqenëse dje isha në Maqedoni, shkova edhe te një pikë shumice dhe i mora edhe atje çmimet e produkteve. Këto janë çmimet e produkteve në Maqedoni, këto janë në Kosovë. Cila është diferenca? Diferenca është se tek të gjitha produktet kemi çmime që shkojnë nga 30% deri në 70% më shumë. Kjo është vërtet një

situatë kritike, alarmante. Kjo, në fakt, nuk duhet ta lerë rehat as ministren e Financave, as qeverinë, ato duhet të gjejnë instrumentet.

Është e papranueshme që qytetarët e Dibrës dhe të Shqipërisë shkojnë në zonat kufitare për të blerë naftë, për të blerë produktet e shportës apo edhe për të marrë valixhen për të ikur jashtë shtetit, sepse është e pamundur mbijetesa këtu në Shqipëri. Faleminderit!